

# Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

## Tremujori I, 2014

**Tiranë, më 04 qershor 2014:** Në tremujorin e parë 2014, indeksi i kushtimit në ndërtim (për banesa) arriti 101,7 % kundrejt tremujorit të parë 2011 (Tremujori i parë 2011=100),


**Në tremujorin e parë 2014 ndryshimi vjetor i indeksit të kushtimit në ndërtim (për banesa) është 0,2 %.** Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,2 %. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2013, grupi "Shpenzime materiale" është ulur me 0,3 %. Uljen më të madhe brenda këtij grupi e pati nëngrupi "Materiale hidro-sanitare" me 2,4 %. Ndërsa, rritja më e madhe në këtë grup vërehet në nëngrupin "Materiale ndërtimi" me 0,3 %.

Indekset e grupeve "Shpenzime page" dhe "Shpenzime transporti" u rritën respektivisht me 3,6% dhe 0,4% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2013.

**Në tremujorin e parë 2014 ndryshimi tremujor i indeksit është - 0,5 %.** Indeksi i çmimeve të grupit "Shpenzime materiale" është ulur me 0,9 % krahasuar me tremujorin e katërt 2013. Brenda këtij grupi uljen më të madhe e pati nëngrupi "Materiale elektrike dhe komunikimi" me 2,3 % dhe rritjen më të madhe nëngrupi "Materiale hidro-sanitare" me 0,3 %.

Indekset e grupeve "Shpenzime transporti" dhe "Shpenzime page" u rritën respektivisht me 2,2 % dhe 1,1% krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Ndërsa, indeksi i grupit "Shpenzime makinerie" u ul 1,5%.

Fig. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) sipas tremujorëve



Tab. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Tremujori i parë 2011=100

Kodi	Grupet	Peshat	I-11	II-11	III-11	IV-11	I-12	II-12	III-12	IV-12	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14
	<b>Totali (1+2+3+4+5+6)</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>99,8</b>	<b>100,2</b>	<b>100,5</b>	<b>100,3</b>	<b>100,7</b>	<b>101,1</b>	<b>101,0</b>	<b>101,5</b>	<b>101,7</b>	<b>101,6</b>	<b>102,2</b>	<b>101,7</b>
1	<b>Shpenzime materiale (a+b+c)</b>	<b>55,2</b>	<b>100,0</b>	<b>100,3</b>	<b>100,5</b>	<b>101,6</b>	<b>99,8</b>	<b>100,6</b>	<b>101,1</b>	<b>99,9</b>	<b>100,1</b>	<b>100,3</b>	<b>101,2</b>	<b>100,7</b>	<b>99,8</b>
	a.Materiale ndërtimi	42,3	100,0	100,4	100,4	101,7	99,9	100,8	101,6	99,7	99,6	100,4	101,6	100,8	99,9
	b.Materiale elektrike dhe komunikimi	6,7	100,0	101,0	101,0	101,2	99,3	99,1	99,3	98,7	101,6	100,7	100,1	102,0	99,7
	c.Materiale hidro-sanitare	6,2	100,0	100,3	100,3	100,9	99,9	100,8	100,1	103,1	102,0	98,9	99,1	99,2	99,5
2	<b>Shpenzime për paga</b>	<b>24,6</b>	<b>100,0</b>	<b>102,6</b>	<b>102,6</b>	<b>101,5</b>	<b>100,8</b>	<b>100,6</b>	<b>101,2</b>	<b>99,8</b>	<b>99,9</b>	<b>101,7</b>	<b>102,6</b>	<b>102,4</b>	<b>103,5</b>
3	<b>Shpenzime makinerie</b>	<b>8,3</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>99,9</b>	<b>100,1</b>	<b>100,9</b>	<b>101,9</b>	<b>103,9</b>	<b>102,9</b>	<b>102,9</b>	<b>105,2</b>	<b>104,6</b>	<b>104,4</b>	<b>102,1</b>
4	<b>Shpenzime transporti</b>	<b>5,3</b>	<b>100,0</b>	<b>98,8</b>	<b>99,4</b>	<b>100,2</b>	<b>100,5</b>	<b>101,7</b>	<b>102,4</b>	<b>102,7</b>	<b>102,4</b>	<b>103,7</b>	<b>102,8</b>	<b>102,6</b>	<b>102,8</b>
5	<b>Shpenzime për energji</b>	<b>2,1</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,3</b>	<b>100,3</b>	<b>100,3</b>	<b>100,3</b>	<b>100,3</b>	<b>100,3</b>
6	<b>Kosto të tjera</b>	<b>4,5</b>	<b>100,0</b>	<b>99,0</b>	<b>97,6</b>	<b>98,7</b>	<b>101,1</b>	<b>100,9</b>	<b>100,3</b>	<b>101,2</b>	<b>103,7</b>	<b>103,1</b>	<b>101,7</b>	<b>102,1</b>	<b>105,6</b>

**Tab. 2 . Ndryshimet tremujore të Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)**

Kodi	Grupet	I-11	II-11	III-11	IV-11	I-12	II-12	III-12	IV-12	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14	%
	<b>Totali (1+2+3+4+5+6)</b>	0,2	-0,2	0,4	0,3	-0,2	0,4	0,4	-0,1	0,5	0,2	-0,1	0,6	-0,5	
<b>1</b>	<b>Shpenzime materiale (a+b+c)</b>	0,4	0,3	0,2	1,1	-1,8	0,8	0,5	-1,2	0,2	0,2	0,9	-0,5	-0,9	
	a.Materiale ndërtimi	0,4	0,4	0,0	1,3	-1,8	0,9	0,8	-1,9	-0,1	0,8	1,2	-0,8	-0,9	
	b.Materiale elektrike dhe komunikimi	0,5	1,0	0,0	0,2	-1,9	-0,2	0,2	-0,6	2,9	-0,9	-0,6	1,9	-2,3	
	c.Materiale hidro-sanitare	0,3	0,3	0,0	0,6	-1,0	0,9	-0,7	3,0	-1,1	-3,0	0,2	0,1	0,3	
<b>2</b>	<b>Shpenzime për paga</b>	0,0	2,6	0,0	-1,1	-0,7	-0,2	0,6	-1,4	0,1	1,8	0,9	-0,2	1,1	
<b>3</b>	<b>Shpenzime makinerie</b>	0,0	0,0	-0,1	0,2	0,8	1,0	2,0	-1,0	0,0	2,2	-0,6	-0,2	-2,2	
<b>4</b>	<b>Shpenzime transporti</b>	0,1	-1,2	0,6	0,8	0,3	1,2	0,7	0,3	-0,3	1,3	-0,9	-0,2	0,2	
<b>5</b>	<b>Shpenzime për energji</b>		0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	
<b>6</b>	<b>Kosto të tjera</b>		-1,0	-1,4	1,1	2,4	-0,2	-0,6	0,9	2,5	-0,6	-1,4	0,4	3,4	

**Tab. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)**

Kodi	Grupet	I-11/II-10	II-11/III-10	III-11/III-10	IV-11/IV-10	I-12/II-11	II-12/II-11	III-12/III-11	IV-12/IV-11	I-13/II-12	II-13/II-12	III-13/III-12	IV-13/IV-12	I-14/II-13	%
	<b>Totali (1+2+3+4+5+6)</b>	0,5	0,2	0,5	0,7	0,3	0,9	0,9	0,5	1,2	1,0	0,5	1,2	0,2	
<b>1</b>	<b>Shpenzime materiale (a+b+c)</b>	0,9	1,1	1,0	2,0	-0,2	0,3	0,6	-1,6	0,3	-0,3	0,1	0,8	-0,3	
	a.Materiale ndërtimi	0,9	1,2	0,9	2,1	-0,1	0,4	1,2	-2,0	-0,3	-0,4	0,0	1,1	0,3	
	b.Materiale elektrike dhe komunikimi	4,5	1,9	1,9	1,7	-0,7	-0,6	-1,7	-2,5	2,3	1,6	0,8	3,4	-1,8	
	c.Materiale hidro-sanitare	0,4	0,4	0,7	1,2	-0,1	0,8	-0,2	2,2	2,1	-1,9	-1,0	-3,8	-2,4	
<b>2</b>	<b>Shpenzime për paga</b>	0,0	0,3	2,6	1,5	0,8	0,3	-1,4	-1,6	-0,9	1,1	1,4	2,6	3,6	
<b>3</b>	<b>Shpenzime makinerie</b>	0,2	0,2	0,1	0,1	0,9	1,9	4,0	2,8	2,0	3,2	0,7	1,5	-0,8	
<b>4</b>	<b>Shpenzime transporti</b>	1,2	-0,8	-0,4	0,3	0,5	2,9	3,0	2,4	1,9	2,0	0,4	0,0	0,4	
<b>5</b>	<b>Shpenzime për energji</b>					0,0	0,0	0,0	0,3	0,3	0,3	0,3	0,0	0,0	
<b>6</b>	<b>Kosto të tjera</b>					1,1	1,9	2,8	2,5	2,5	2,2	1,4	0,9	1,9	

# Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjerë joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. IKN duke filluar nga tremujori i parë 2011 llogaritet me shportën e re të materialeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimit. Tremujori i parë i vitit 2011 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 73 zëra nga të cilat 68 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mbledhen nga 126 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 50 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Për llogaritjen e Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0t}^L = \frac{\sum_{i=1}^n \left( \frac{p_t^i}{p_0^i} \times w_0^i \right)}{\sum_{i=1}^n w_0^i} \times 100$$

Ku:

$I_{ot}$  = Indeksi i periudhës t krahasuar me periudhën bazë 0

$p_t^i$  = Çmimi për njësi i artikullit i në një periudhën t (koha korente)

$p_0^i$  = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën 0 (periudha bazë)

$w_0^i$  = Pesha e artikullit i në periudhën bazë

### **Matësit e Indeksit**

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit të tanishëm me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit të tanishëm me tremujorin e mëparshëm .